



PSH .nr. 719/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të: z. Nuhi Paçarizi - Kryetar, z. Blerim Dina - Referues, z. Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: Grupi i OE N.T.Sh “Marash-Shped” Shpk & “Company Zuka Commerce” Shpk- Gjakovë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë OE N.N.Sh “Korben” - Gjakovë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Sanimi dhe Ndërtimi i parqeve”, me nr. të prokurimit: 632-20-1237-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK): Kuvendi Komunal Gjakovë, më datën: 18.10.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, si pjesërisht e bazuar ankesa e Grupit te operatoreve ekonomik: N.T.Sh “Marash-Shped” Shpk & “Company Zuka Commerce” Shpk- Gjakovë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Sanimi dhe Ndërtimi i parqeve”, me nr. të prokurimit: 632-20-1237-5-2-1, iniciuar nga AK K K Gjakovë.

II. ANULOHET, njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “**Sanimi dhe Ndërtimi i parqeve**”, me nr. të prokurimit: 632-20-1237-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK): Kuvendi Komunal Gjakovë, dhe lënda kthehet në **Ri-vlerësim**.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e Grupit te operatoreve ekonomik: N.T.Sh “Marash-Shped” Shpk & “Company Zuka Commerce” Shpk- Gjakovë, aprovet si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI .Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues Grupi i operatoreve ekonomik: N.T.Sh “Marash-Shped”Shpk & “Company Zuka Commerce”Shpk- Gjakovë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me dt: 25.09.2020 me nr. 719/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Sanimi dhe Ndërtimi i parqeve”, me nr. të prokurimit: 632-20-1237-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK): Kuvendi Komunal Gjakovë, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet: 6, 7, 56, 59, 60, 69, dhe 71 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës si dhe nenin 27 të RRUOPP-së.
- AK ka shkelur edhe dispozitat e RRUOPP-së gjatë vlerësimit, krahasimit dhe sqarimit të tenderëve si dhe ka shkelur edhe praktikën e mira të prokurimit.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 01.10.2020, ka autorizuar ekspertin profesional të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti profesional i prokurimit në raportin e dt: 12.10.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:

Përgjigje në Pretendimin 1

Lidhur me pretendimin e grupit të OE N.T.Sh”Marash-Shped”Shpk & “Company Zuka Commerce”Shpk,se AK gjatë fazës së rivlerësimit,ekzaminimit dhe krahasimit të tenderëve ka eliminuar ofertën e tyre me arsyetimin se në formularin për dorëzimin e tenderit lider i grupit është OE N.T.SH “Marash Shped” Shpk, ndërsa në deklaratën e grupit është specifikuar që lideri i grupit është OE”Company Zuka Commerce” dhe pas ndryshimit të liderit sipas vlerësimit të AK-së lideri i grupit (N.T.Sh”Marash-Shped”Shpk) nuk e plotëson kërkesën e dosjes së tenderit për kontrata dhe referenca të realizuara ku është kërkuar që lideri duhet të ketë 60 % të vlerës së kontratave të realizuara prej së paku 300,000.00 € në tri vitet e fundit, që sipas OE ankues në deklaratën për themelimin e grupit të OE shumë qartë është theksuar që lider i grupit është OE

“Company Zuka Commerce” dhe AK nuk ka bërë vlerësimin e tenderëve konform nenit 59 të LPP-së dhe nenit 27 të RRUOPP-së, ekspertit shqyrtues ka këtë mendim.

Në vendimin e AK-së ”B42 Letër standarde për tenderuesin/kandidatin e eliminuar”, AK ka theksuar se tenderi i grupit të OE N.T.Sh”Marash-Shped”Shpk & “Company Zuka Commerce”shpk është administrativisht i papërgjegjshëm me asyetimin se në procesverbalin e hapjes së tenderit, figuron si Lider i Grupit OE N.T.Sh”Marash-Shped”Shpk, ndërsa në dokumentacionin e dorëzuar është ndryshuar Lideri i grupit ”Company Zuka Commerce”. Sipas rregullave të prokurimit publik ofertën e dorëzon bartësi dhe kjo specifikohet në formular për dorëzimin të tenderit si Operator Ekonomik me nr.1 ndërsa në deklaratën për themelimin të grupit të jepen OE tjerë, pra duhet shikuar Operatori Ekonomik i cili është me nr.1 në formularin e krijuar të sistemit. Sipas vendimit të OSHP-së, nr.781/19 i datës 09.12.2019 bartës i projektit është OE i cili i pari e dorëzon ofertën në e-prokurim nr 1.” meqenëse ka mospërputhje mes liderit të dhënë në formular dhe deklarata për themelimin e grupit. Ju si Lider i grupit nuk i përmbushni 60% të vlerës prej 300,000.00 € ashtu siq është kërkuar në FDT (Vendimi i AK-së).

Eksperti shqyrtues sqaron se grupi OE N.T.Sh”Marash-Shped”Shpk & “Company Zuka Commerce”Shpk së bashku më dosjen e tenderit ka dorëzuar edhe Akt marrëveshjen për themelimin e grupit të OE në të cilën është specifikuar që Lider i grupit është OE “Company Zuka Commerce”Shpk ndërsa OE N.T.Sh”Marash-Shped”Shpk është anëtar i grupit.

Gjithashtu ky grup i OE kanë dorëzuar edhe një autorizim të vulosur dhe nënshkruar nga të dy anëtarët e konzorciumit në të cilin është theksuar që Albert Bala (përfaqësues i anëtarit të konzorciumit N.T.Sh”Marash-Shped”Shpk) autorizohet për të nënshkruar dhe dorëzuar dosjen e tenderit apo për të ofruar informata shtesë mbi atë apo nëse shpallet fitues edhe të nënshkruaj kontratën me autoritetin kontraktues.

Eksperti shqyrtues sqaron se në bazë të dokumenteve të dorëzuara Lider i grupit është OE “Company Zuka Commerce”Shpk dhe nuk ka ndryshim të Liderit të grupit ndërsa personi z.Albert Bala është i autorizuar nga anëtarët e konzorciumit për dorëzimin e dosjes apo edhe për nënshkrimin e kontratës dhe këtu nuk kemi të bëjmë me ndryshim të Liderit të grupit.

Duke ju referuar arsyetimit të AK-së se në bazë të rregullave të prokurimit publik ofertën e dorëzon bartësi dhe kjo specifikohet në formular për dorëzimin të tenderit, ekspertit shqyrtues sqaron se në LPP dhe legjislacionin dytësor apo në dosje të tenderit askund nuk precizohet apo ndalohej që tenderi të dorëzohet nga ndonjë anëtar i konzorciumit.

Gjithashtu edhe arsyetimi i AK-së për eliminim të OE ankues bazuar në vendimin e OSHP-së PSH.781/19 të datës 09.12.2019 sipas të cilit bartës i projektit është OE i cili i pari e dorëzon ofertën në e-prokurim, për ekspertin shqyrtues është nxjerr nga konteksti sepse në atë vendim është cekur se lider ka qenë i caktuar OE i cili ka qenë edhe dorëzues i ofertës, ndërsa për rastin konkret Lider i grupit është caktuar OE “Company Zuka Commerce” Shpk ndërsa me autorizim të anëtarve të konzorciumit është autorizuar z. Albert Bala të dorëzoj tenderin apo edhe nënshkruaj kontratën në rast se ky grup shpërblehet me kontratë.

Bazuar edhe në interpretimin e KRPP-së të datës 09.10.2020 në të cilin thuhet “Asnjë nga dispozitat e LPP-së dhe të legjislacionit dytësor nuk e ndalon që tenderi të dorëzohet nga një anëtar i konzorciumit.

E rëndësishme është që tenderi të ngarkohet si grup i operatorëve ekonomik (konzorcium) në sistemin elektronik të prokurimit publik”

Eksperti shqyrtues konstaton se dokumentet e grupit të OE N.T.Sh”Marash-Shped” Shpk & “Company Zuka Commerce” Shpk lidhur me themelimin e grupit të operatorëve ekonomik dhe autorizimi për z. Albert Bala janë konform LPP-së, legjislacionit sekondar dhe kërkesave të parashtruara në dosje të tenderit dhe njoftimit për kontratë, andaj pretendimi ankimor i OE ankues është i bazuar dhe rekomandoj që lënda të kthehet në rivlerësim dhe AK të rivlerësoj tenderin konform nenit 59 të LPP-së duke pasur në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues **të aprovohet si e bazuar**, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në **rivlerësim**.

Autoriteti Kontraktues, me datë: 14.10.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se NUK PAJTOHET me mendimin e ekspertit shqyrtues. Ne nuk pajtohemi me mendimin e ekspertit shqyrtues që lëndë atë kthehet në rishqyrtim. Autoriteti Kontraktues Komuna Gjakovë qëndron para vendimit të marr.

Operatori Ekonomik, me datë: 13.10.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se PAJTOHT me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 28.10.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbal mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit

të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit profesional të prokurimit, dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues/ profesional deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi, sqaron se ankesa është parashtruar kundër njoftimit për dhënie të kontratës.

Lidhur me pretendimin e grupit të OE N.T.Sh"Marash-Shped"Shpk & "Company Zuka Commerce" Shpk, se AK gjatë fazës së rivlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të tenderëve ka eliminuar ofertën e tyre me arsyetimin se në formularin për dorëzimin e tenderit lider i grupit është OE N.T.SH "Marash Shped" Shpk, ndërsa në deklaratën e grupit është specifikuar që lideri i grupit është OE"Company Zuka Commerce" dhe sipas vlerësimit të AK-së lideri i grupit (N.T.Sh"Marash-Shped"Shpk) nuk e plotëson kërkesën e dosjes së tenderit për kontrata dhe referenca të realizuara ku është kërkuar që lideri duhet ti ketë 60 % të vlerës së kontratave të realizuara prej së paku 300,000.00 € në tri vitet e fundit, që sipas OE ankues në deklaratën për themelimin e grupit të OE shumë qartë është theksuar që lider i grupit është OE "Company Zuka Commerce" dhe AK nuk ka bërë vlerësimin e tenderëve konform nenit 59 të LPP-së dhe nenit 27 të RRUOPP-së.

Paneli shqyrtues sqaron se pas administrimit dhe shqyrtimit të provave ka gjetur se grupi OE N.T.Sh"Marash-Shped" Shpk & "Company Zuka Commerce" Shpk së bashku më dosjen e tenderit ka dorëzuar edhe Akt marrëveshjen për themelimin e grupit të OE në të cilën është specifikuar që Lider i grupit është OE "Company Zuka Commerce" Shpk ndërsa OE N.T.Sh"Marash-Shped"Shpk është anëtar i grupit.

Bashkangjitur me dokumentacion në sistemin e e-prokurimit grupi i operatorëve ekonomik kanë dorëzuar një autorizim të vulosur dhe nënshkruar nga të dy anëtarët e konzorciumit në të cilin është theksuar që Albert Bala (përfaqësues i anëtarit të konzorciumit N.T.Sh"Marash-Shped"Shpk) autorizohet për të nënshkruar dhe dorëzuar dosjen e tenderit apo për të ofruar informata shtesë mbi atë apo nëse shpallet fitues edhe të nënshkruaj kontratën me autoritetin kontraktues.

Duke pasur parasysh faktin se në dokumentet e ofruara nga konzorciumi ankues ekziston marrëveshja që Lider i grupit është OE "Company Zuka Commerce"Shpk ndërsa personi z. Albert Bala është i autorizuar nga anëtarët e konzorciumit për dorëzimin e dosjes apo edhe për nënshkrimin e kontratës paneli shqyrtues konsideron se duke pas parasysh faktin se është krijuar një paqartësi lidhur me përcaktimin e liderit për grupin e OE-ve, në fjalë konsiderojmë se AK me rastin e rivlerësimit duhet të sqarojë këtë fakt dhe të vërtetohet se kush është lideri i grupit të OE-ve ankues në mënyrë që ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në pajtim me nenin 59 të LPP-së.

Paneli shqyrtues ka analizuar edhe interpretimin e KRPP-së të datës 09.10.2020 në të cilin thuhet “Asnjë nga dispozitat e LPP-së dhe të legjislacionit dytësor nuk e ndalon që tenderi të dorëzohet nga një anëtar i konzorciumit. E rëndësishme është që tenderi të ngarkohet si grup i operatorëve ekonomik (konzorcium) në sistemin elektronik të prokurimit publik”.

Paneli shqyrtues vlerëson që lënda të kthehet në rivlerësim dhe AK të rivlerësoj tenderin konform nenit 59 të LPP-së duke pasur në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.



Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK - Kuvendi Komunal Gjakovë

1x1 OE - T.SH"MARASH-SHPED" & "COMPANY ZUKA COMMERCE" SHPK

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.